

FJALA E DEPUTETIT SALI BERISHA

E ENJTE 5 TETOR 2023

E filluat seancën me një albanofobi, që do të gdhendet në muret e historisë si një nga aktet më të turpshme të këtij Parlamenti, të kontrolluar totalisht nga një argat i shpifur i Vladimir Vuçiçit, apo, siç e cilësuan së fundi, “Pashiçi shqipfolës”, Edi Rama. Nuk mundet, në qoftë se do të kishit një nanogramë ndërgjegjeje kombëtare, të ishit më pak se qindra e qindra deputetë të Parlamentit Europian, të cilët u mblodhën para dy ditësh dhe dënuan në tempullin e demokracisë europiane, me forcën më të madhe, aktin terrorist, agresionin direkt të Vuçiçit, të qeverisë së tij ndaj Republikës së Kosovës. Ne nuk mund ta kapërdijmë këtë qëndrim tuajin sot, në një kohë kur në aulën e Parlamentit Europian deputetët e nderuar, nga rajoni dhe jo vetëm nga rajoni, kërkuan vendosjen e sanksioneve ndaj Serbisë; kërkuan sanksionimin e Vuçiçit; dënuan futjen e armëve, kurse ju vini me kurthe e skenarë, merrni pengje dhe i nxirrni këtu të shpërfytyruar. Çfarë kujtoni ju, se mund t’i mashtroni shqiptarët në këtë mënyrë? Këto janë histori të turpshme, këto vetëm ju turpërojnë më shumë. Del ministri i Mbrojtjes dhe thotë se nuk tha: “Kosova”, por tha: “Veriu i Kosovës”. A di çfarë flet ky, apo jo? Sovraniteti dhe integriteti territorial është një në të gjithë territorin. Çfarë dallimi paska Kosova me Veriun e Kosovës, atëherë? Na thoni pak ju! Si ka mundësi që argati i Vuçiçit, në krye tuaj, lëshon komunikatën e parë pa shprehur ngushëllime për shqiptarin, që derdhi gjakun në mbrojtje të asaj që ky thotë është ‘no man’s land’? E vetmja mundësi është se ishte marrë vesh me Vuçiçin tre ditë më parë në OKB, e vetmja mundësi është se ai ishte i njohur me skenarin dhe kishte të gatshme në tavolinë deklaratën, ku do të kërkonte, sapo të kërciste, thirrjen e konferencës së jashtëzakonshme. Por projektin atyre ua dogji në dorë policia e Kosovës, me guximin, trimërinë, profesionalizmin e lartë të saj, ku i tregoi Edi Ramës se ajo është tokë e zotëve të Kosovës; i tregoi Edi Ramës se cilatdo qofshin falangat terroriste të Aleksandër Vuçiç, sado të armatosura të jenë ato, nuk do të mund të dominojnë në asnjë metër katror të asaj toke.

Unë dua t’ju pyes: kush flet prej muajsh, në mos vitesh, për Donbasin? Kush flet për projektin e Putinit në rajon? Asnjë tjetër, përveç Edi Ramës; vetëm Edi Rama. Mirëpo, nuk po përdor shprehje për të prishur gojën time, kjo nuk është naive, por idioteske. Donbasi u krijua nga Putini në kufi me Ukrainën, kurse Kosova në Veri, në Jug, në Lindje, në Perëndim, në të gjithë territorin e saj, është territor, në kuptimin e sigurisë, i NATO-s dhe vetëm i NATO-s. Le ta provojë “Putini i vogël” njëherë se si do ta marrë përgjigjen e dytë shkatërrimtare për vendin e tij, se si do të përballet brenda orësh me një përgjigje të tillë nga NATO-ja, sa nuk mund ta imagjinojë më kurrë tjetër. E kujt ia thotë ky: Donbas, Donbas, Donbas? Çfarë është ky, shqiptar? Çfarë shqiptari është ky? Ky është një lëvozhgë e Aleksandër Vuçiçit, një i keqpërdorur në shkallën më ekstreme, një turp kombëtar. Kush tha Donbas tjetër, përveç atij, më thoni pak? Kush ka folur për republikë KFOR-i deri më sot, përveç atij? Kush tha se Kosova mund të zhduket, përveç atij? Dhe ju detyron ju që sot, në vend që të debatojmë për agresionin, për aktin terrorist të Serbisë ndaj Kosovës, të nxirrni pengun këtu. Po çfarë tregoni këtu? Fytyrën tuaj tregoni ju me pengun. Çfarë kujtoni, se na dëmtoni ne? Jo, jo, në asnjë mënyrë; ne këtu jemi dhe do të qëndrojmë në ato gjëra që besojmë, dhe kjo është arsyeja. Do të them dy fjalë për këtë ligj albanofob: turp, turp! Këta, të cilëve ju u prisni këtë bonus, sjellin në Shqipëri miliarda. Kjo është një shenjë ndaj tyre. Kudo që të lindësh, Shqipëria të prek me diçka. Me këtë nuk është se atyre u ndryshon jetën. Por është turp! Si mund të sillni një ligj të tillë? Si jeni kaq shpirtligj, kaq të kufizuar, kaq joshqiptarë? Po, dyfishojeni bonusin për ata që janë në Shqipëri dhe lini atë që është për ata, që supozojmë se mund shkojë 20 milionë euro. Po çfarë janë 20 milionë euro, në një kohë kur prindërit e tyre sjellin në Shqipëri qindra milionë euro? Si mund të sillni një ligj të tillë? Po ju e sillni se jeni të shpërfytyruar nga sensi, materia kombëtare, nuk keni ndërgjegje!

Çfarë t'ju thuash juve? Është e turpshme që sillet një ligj i tillë! Së fundi, dua të dënoj me forcën më të madhe kërcënimet ndaj punonjësve të drejtësisë. Dënoj me ashpërsinë më të madhe, si një ndër krimet më të rënda, çdo kërcënim ndaj çdo hetuesi, prokurori, gjykatësi, gazetari dhe cilido tjetër. Këtu dua të theksoj, dua të ndalem, se këto kërcënime shfrytëzojnë rrjedhjen e informacioneve, shfrytëzojnë pazarin që bëhet me informacionet. Kush i bën? Militantët tuaj i bëjnë, patronazhistët tuaj i bëjnë. Ata i nxjerrin dosjet në treg te kriminelët dhe kriminelët pastaj u vërsulen prokurorëve dhe gjykatësve. Këto kërcënime... Ja një sekondë dhe e mbylla. Kujt i vijne këto kërcënime? A e dini se të gjithë ata që janë marrë dhëmb për dhëmb me bandat, siç ishte Selimi, unë nuk e njoh, siç është kjo tjetra në SPAK, ata dekonspirohen nga njerëzit tuaj, militantët, të cilët shesin informacione. Ju bëj një pyetje: si ka mundësi që nuk gjendet asnjë rrjedhës i informacioneve të dosjeve topsekret, se dosjet e drejtësisë janë topsekret kudo në botë? Kjo është bërë rrugë dhe asnjë nuk gjendet. Kjo është një formë e tmerrshme presioni ndaj tyre. Natyrisht, kur vihet në krye Taulant Balla, njeriu i lidhur më shumë se kushdo tjetër me bandat, nga të mos dalë çdo sekret? Më fal! E mbylla. Nuk gjeni një rrjedhës, sepse jeni vetë rrjedhës. Zonjë, propozimi im është ky: çdo politikan, çdo deputet apo deputete që ka përdorur EncroChat, që ka përdorur aplikacionin Sky ECC apo që ka përdorur telefona të tjerë të kriptuar, duhet të jetë objekt i dekriminalizimit. Shoh se po largoni policë, shumë mirë, por në radhë të parë duhet të bëjmë transparencën e politikanëve, se ata janë udhëheqësit e kriminit të organizuar. Të nxjerrë kush ka pasur...

FJALA E DEPUTETIT SALI BERISHA

E ENJTE 5 TETOR 2023

Të dashur qytetarë dhe qytetare,

Marrëveshja që votohet përbën një grant të Komisionit Europian, dhuratë bujare, në totalin e miliarda eurove që ky institucion u ka dhënë Shqipërisë dhe shqiptarëve nga paratë e taksapaguesve të BE-së. Në këtë kontekst, është një rast për të shprehur mirënjohje si ndaj Komisionit, edhe ndaj taksapaguesve të BE-së, gjithashtu është një rast për t'ju bërë thirrje Komisionit Europian dhe institucioneve europiane që të ndjekin çdo qindarkë që disbursohet në këtë vend, pasi hajdutë si këta qeveritarë nuk gjenden në Europë, ndoshta edhe në botë. Meqenëse këtu u bë një debat, ku u fol për rrugë dhe për ura, jam këtu për t'ju thënë shqiptarëve se gjatë 9 vjetëve për punë të ndryshme dhe shpenzime janë investuar 1,1 trilionë lekë; me kursin e sotëm 10,1 miliardë euro. 10,1 miliardë euro janë vjedhur në masën nga 50% deri në 90%. Do t'ju jap disa fakte zyrtare për vjedhjet. Nëse Rrugës së Arbrit deri tani i shkon 11 milionë euro kilometri, në Kroaci autostrada, 27 metra e gjerë, me standarde europiane (po të doni ua lexoj edhe segmentin) u ndërtua me 1,5 milionë euro. Nëse 7,5 kilometrat e para të Unazës së Tiranës (gjithsej 17 kilometra), me gjitha veprat e shumta të artit që kishte, u ndërtuan me 2,5 milionë euro, ju keni ndërtuar zgjerimin te sheshi "Shqiponja" me 24 milionë euro. A ka në botë hajni si këta?! Po marr rrugën Kardhiq-Delvinë. Sipas të dhënave tuaja, 16,6

kilometra në të dyja drejtimet, nga Delvina dhe nga Kardhiqi, u ndërtuan me koston 680 mijë euro kilometri. E keni rritur koston nga 30 milionë që ishte, madje më pak, në 145 milionë. Po, është ndërtuar një tunel 800 metra, por janë vjedhur 100 milionë euro. Çfarë bëtë me tunelin e Llogarasë? Ku e keni? Në mënyrën me kriminale shpuat në gjerësi 7 kilometra, në një kohë kur pak metra më poshtë mund të shpohej me 3 kilometra tuneli dhe me ato para mund të ndërtohej e gjithë Unaza e Karaburunit. Nuk ka hajdutë në botë si ju, a e kuptoni, apo jo! Nuk mund të ketë! Ku e keni rrugën Korçë- Qafë Plloçë? Ka 12 vjet që punimet kanë mbetur në vend dhe rruga ju del me disnivel 30-40 metra. 4 kilometra të rrugës Korçë-Kolonjë, nga 4 milionë euro në çmimin maksimal, po kushtojnë 40 milionë euro, sipas të dhënave tuaja. Hajdutë si ju nuk ka toka! Kjo nuk ndodh në asnjë komb, në asnjë vend. Shkoni në Korçë: ju ndërtoni katër kilometra me 40 milionë euro, 10 milionë euro kilometri. Këta janë të çmendur! Janë të paimagjinueshëm! Na thonë: na jep shifra. Hajdeni t’jua them unë me shifra deri nesër, nëse doni. Çfarë bëni? Ku i çoni? Rruga e Kombit, Hani i Hotit dhe Muriqani sjellin në Shqipëri 55-60% të vizitorëve, por keni 10 vjet që i ndëshkoni me grykën e shishes, Thumanë-Fushë Krujë. E keni bërë udhëtimin nga Tirana në Shkodër infernal. Rruga e parë që duhet zgjeruar, mbi të gjitha, është Lezhë-Shkodër. Përkundrazi! Çfarë keni bërë në Rrugën e Kombit? Më thoni! Nuk keni bërë as edhe një metër linear në segmentin Milot-Rrëshen, përveç taksës. Po si mund të recitoni këtu? Ju sikur pini drogë! Më vjen keq që e them këtë! Unë nuk e perceptoj dot që njerëz me arsye mund të flasin në këtë mënyrë në këtë platformë! Si mund të flasin në këtë mënyrë?! Duhet të kenë sensin e punëtorit, e përgjegjësisë. Janë të vërteta këto, apo jo? Të gjitha këto janë të vërteta! Po djegëset? Institucionet ndërkombëtare thonë se janë zhdukur 90% e parave. Ku janë 200 milionë euro të taksapaguesve? Ku janë? A e morët vesh që Alqi Bllakon e liruan? E liruan për shkak të Erion hajdutit; e liruan për shkak të Erion Veliajt, sepse ka zbatuar skemën më kriminale 1- miliardëshe. Mirë ia bënë Lifterit, shumë mirë ia bënë, që nuk i nxjerr të gjitha! Para së të përfundoj, dua të dënoj me forcën më të madhe qëndrimin që mbajti ndaj Kosovës Edi Rama në Spanjë. Edi Rama në Spanjë nuk shqipëroi asnjë fjalë... Me këtë e filluam, me këtë do ta mbyllim. Foli si zëdhënës i Vuçiçit: “Kemi bërë çdo gjë për Kosovën, për njohjen e saj”. Një gënjeshtar i paparë! Asnjë njohje, përkundrazi ka dekurajuar njohjet, jo një, por disa. Po, po...